

# Udhëzues për përgatitjen, realizimin dhe ndjekjen e e programit zhvillimor të shkollës

## **Përmbajtja**

<b>Hyrje</b> .....	2
<b>1. Çfarë është planifikimi zhvillimor shkollor dhe Programi zhvillimor i shkollës</b> .....	3
<b>2. Dokumente dhe burime të lidhura me programin zhvillimor të shkollës</b> .....	4
<b>3. Kush e harton programin zhvillimor të shkollës: rolet e secilit nga faktorët</b> .....	5
3.1. Anëtarët e ekipit për hartimin e programit zhvillimor të shkollës .....	5
3.2. Roli i secilit prej faktorëve .....	6
3.2.1. Drejtoria shkollore .....	6
3.2.2. Këshilli shkollor .....	6
3.2.3. Kuadri edukativo-arsimor shkollor.....	7
3.2.4. Nxënësit.....	8
3.2.5. Prindërit.....	9
3.2.6. Vetëqeverisja lokale .....	9
3.2.7. Bashkësia lokale, organizatat qytetare, institucionet me të cilat bashkëpunon shkolla .....	10
<b>4. Fazat dhe hapat në hartimin dhe realizimin e Programit zhvillimor të shkollës</b> .....	11
4.1. Faza e përgatitjes (para planifikimit) .....	11
4.2. Faza e planifikimit.....	15
4.3. Faza e realizimit .....	20
4.4. Faza e vlerësimit – përcaktimi i gjendjes momentale – përgatitja e ciklit të ri të planifikimit.....	21
<b>5. Struktura e planeve të veprimit në kuadër të Planifikimit zhvillimor të shkollës</b> .....	23
<b>6. Struktura e programit zhvillimor të shkollës</b> .....	27
Shtojca 1. Skema e roleve të faktorëve .....	28
Shtojca 2. Forma e programit zhvillimor për punën e shkollës fillore.....	28
Shtojca 3. Lista për kontrollin e pjesëmarrjes së faktorëve në procesin e hartimit të Programit zhvillimor të shkollës .....	38
Shtojca 4. Lloji i indikatorëve .....	39

## Hyrje

Përmirësimi i cilësisë së punës së shkollës është proces i vazhdueshëm që nënkupton vizion të qartë, udhëheqje të përkushtuar dhe qasje gjithëpërfshirëse. Shkollat në organizimin e tyre përfshijnë palë të ndryshme të interesuara të cilat duhet të kenë mirëkuptim të përbashkët për drejtimin në të cilin duhet të zhvillohet shkolla në mënyrë që të sigurohet se të gjithë nxënësit kanë qasje në arsimin e kualitetit të lartë dhe i arrijnë potencialet personale.

Kjo nënkupton vendosjen e pritjeve të qarta për qëllimet që duhet të arrihen në periudhë të caktuara kohore dhe mënyrat në të cilat të njëjtat duhet të arrihen. Në mënyrë që të arrihet kjo, është e domosdoshme kultura e hapjes dhe transparencës, ku palët e interesuara inkurajohen të japin informacione kthyesë dhe të përfshihen në dialog për anët e forta të shkollës dhe fushat për përmirësim. Qasja e këtyre do të thotë se përmirësimi i shkollës nuk është përgjegjësi e një individi ose grupi, por përgjegjësi e përbashkët e të gjitha palëve të interesuara, duke përfshirë udhëheqësin, mësuesin, bashkëpunëtorët profesionalë, komunën, prindërit/kujdestarët (në tekstin e mëtejshëm prindërit dhe nxënësit).

Ky udhëzues ka për qëllim t'u ndihmojë shkollave në procesin e planifikimit zhvillimor, që përfshin përgatitje të programit zhvillimor të shkollës, realizimin e saj dhe ndjekjen e realizimit. I njëjti është zhvilluar në bazë të nevojës reale për qasje më sistematike ndaj këtyre proceseve dhe është imagjinuar si udhërrëfyes për shkollat në zbatimin efikas të procesit të planifikimit zhvillimor dhe përgatitjes së programit zhvillimor. Njëherësh, ofron përshkrime të roleve që faktorë të ndryshëm i kanë në vetë procesin, fazat dhe hapat që i ndihmojnë shkollës të hartojë program të mirë zhvillimor, të njëjtin ta zbatojë, ta vlerësojë suksesin dhe, sipas nevojës, ta rishikojë, me qëllim që të sigurojë përmirësim dhe zhvillim të vazhdueshëm.

## 1. Çfarë është planifikimi zhvillimor shkollor dhe Programi zhvillimor i shkollës

**Planifikimi zhvillimor shkollor** është proces i vazhdueshëm dhe krijues i cili mbështetet në hulumtimin dhe dallimin e vazhdueshëm të nevojave autentike të shkollës dhe konceptim të mënyrave në të cilat do të plotësohen ato nevoja. Në procesin e planifikimit zhvillimor shkollor shkollat janë iniciatorë dhe aktorë të ndryshimeve personale. Përmes miratimit të vendimeve të rëndësishme, ato ndikojnë në shumë aspekte që lidhen me nevojën personale, me çka realizojnë nivel më të madh të autonomisë.

**Programi zhvillimor i shkollës** paraqet dokument strategjik në të cilin është planifikuar procesi i zhvillimit dhe avancimit të shkollës. Ai është dokument në të cilin përkufizohen prioritetet në kuadër të punës edukative-arsimore të shkollës që duhet të avancohen dhe zhvillohen për periudhë prej katër viteve dhe paraqet bazën për hartimin e Programit vjetor për punën e shkollës. Në hartimin dhe realizimin e Programi zhvillimor të shkollës duhet të përfshihen të gjithë ata të cilët drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë janë të përfshirë në punën e shkollës (të punësuarit në shkollë, nxënësit, prindërit, përfaqësuesit e bashkësisë lokale).

Ndryshimet e planifikuara me programin zhvillimor të shkollës duhet fillimisht të orientohen drejt ngritjes së cilësisë së mësimin, arritjeve të nxënësve, mundësimin e mjedisit të sigurt dhe nxitës për nxënie, zhvillim të kompetencave të kuadrit mësimdhënës dhe udhëheqës dhe përfshirje të prindërve/kujdestarëve në arsimimin e fëmijëve të tyre.

## 2. Dokumente dhe burime të lidhura me programin zhvillimor të shkollës

Në mënyrë që të veçohen prioritetet për zhvillimin e shkollës duhet të fillohet nga rezultatet nga **vetevaluimi i shkollës** dhe analiza e gjendjes në vetë shkollën.

Sipas kësaj, procesi i vetevaluimit dhe procesi i planifikimit zhvillimor të shkollës janë dy proceset të lidhura ngushtë, me ç'rast vetevaluimi i paraprinë planifikimit zhvillimor dhe raporti nga vetevaluimi i zbatuar shërben si burim i informacioneve për gjendjen e shkollës dhe nevojat parësore të saj. Krahas kësaj, vetevaluimi shërben edhe si mekanizëm kontrollues përmes të cilit ndiqet realizimi i qëllimeve të vendosura në Programin zhvillimor të shkollës, duke marrë parasysh faktin se vetevaluimi zbatohet në çdo dy vjet, respektivisht para hartimit të Programit zhvillimor të shkollës, në mes të periudhës së realizimit të Programi zhvillimor dhe në fund të realizimit të Programit zhvillimor.

Në procesin e përpilimit të programit zhvillimor të shkollës detyrimisht duhet të merren parasysh edhe rezultatet nga **evaluimi integral** i shkollës dhe rekomandimet që rezultojnë prej tij.

Rezultatet nga vetevaluimi dhe evaluimi integral i shkollës japin pasqyrë të funksionimit të shkollës, për anët e forta dhe të dobëta, për resurset ekzistuese në të gjitha fushat e punës së shkollës dhe rreziqet e forta dhe të dobëta, për resurset ekzistuese në të gjitha fushat e punës së shkollës dhe rreziqet/pengesat e mundshme që ndikojnë në zhvillimin e shkollës. Në bazë të këtyre të dhënave, definohen misioni dhe vizioni i shkollës, si pasqyrë e shkollës me të gjitha specifikat e saj dhe qëllimet që shkolla planifikon t'i arrijë në periudhë prej katër viteve.

Programi zhvillimor i shkollës është i lidhur ngushtë edhe me **programin vjetor për punën e shkollës**. Në fakt, në programin vjetor të shkollës për çdo vit shkollor planifikohen aktivitetet e parashikuara që janë të lidhura me qëllimet zhvillimore nga Programi zhvillimor i shkollës sipas dinamikës së planifikuar. Në raportin vjetor për punën e shkollës përmendet se çfarë është realizuar vitin paraprak shkollor, ndërsa në programin vjetor se çfarë planifikohet të realizohet në vitin rrjedhës shkollor. Qasja e këtillë në fakt është pjesë e monitoringut, respektivisht ndjekja nëse ajo që është planifikuar realizohet sipas dinamikës së parashikuar.

### 3. Kush e harton programin zhvillimor të shkollës: rolet e secilit nga faktorët

Shkolla i bashkon interesat dhe nevojat e nxënësve, mësimezhënësve, prindërve dhe bashkësisë lokale, kështu që në planifikimin e zhvillimit të tij është e domosdoshme pjesëmarrja, iniciativa, bashkëpunimi dhe përgjegjësia e të gjithë faktorëve, me ç'rast secili prej tyre ka rolin personal që është thelbësor për arritjen e rezultateve të dëshiruara. Me pjesëmarrjen e tyre demokratike në procesin e planifikimit zhvillimor sigurohet:

- hapje ndaj ndryshimeve,
- pasuri e iniciativave dhe ideve,
- arritshmëri dhe objektivitet më i madh në ndjekjen e kualitetit të punës edukativo-arsimore të shkollës,
- zhvillim i bazuar në nevojat autentike të shkollës,
- gatishmëri më të madhe të të gjithë faktorëve për marrjen përsipër të përgjegjësisë,
- cilësi më e mirë në punën e shkollës dhe nivel më të lartë të kënaqësisë.

#### 3.1. Anëtarët e ekipit për hartimin e programit zhvillimor të shkollës

- Drejtori i shkollës
- Bashkëpunëtorët profesionalë
- Mësimezhënës
- Përfaqësuesi/it e prindërve
- Përfaqësuesi/it e nxënësve
- Përfaqësuesi i vetëqeverisjes lokale

Përzgjedhja e anëtarëve bëhet në mënyrën si vijon:

- Anëtarët nga radhët e mësimezhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë përzgjidhen në seancë të Këshillit të mësimezhënësve, me ç'rast duhet marrë parasysh që të jenë të përfaqësuar bashkëpunëtorët profesional, mësimezhënësit klasor, mësimezhënësit lëndorë, mësimezhënësit që mbajnë mësim në shkollë rajonale, etj.
- Anëtari nga radhët e prindërve përzgjidhet në seancën e Këshillit të prindërve.
- Anëtari nga radhët e nxënësve përzgjidhet në mbledhjen e Parlamentit të nxënësve.

Përzgjedhja e anëtarëve bëhet sipas rregulloreve dhe procedurave ekzistuese për përzgjedhjen e organeve.

- Anëtari i vetëqeverisjes lokale delegohet nga të punësuarit nga Sektori me kompetencë për arsimin në komunë.

Përzgjedhja e anëtarëve të propozuar duhet të jetë në përputhje me rregulloret dhe praktikat për përzgjedhjen e trupave të ndryshme.

Drejtori i shkollës dhe anëtarët nga radhët e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë janë përgjegjës për hartimin e dokumentit të Programit zhvillimor të shkollës, derisa anëtarët tjerë duhet të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin me informacione, propozime, sugjerime të tyre dhe të jenë në komunikim të vazhdueshëm me palët e interesuara të cilat i përfaqësojnë.

Këshilli shkollor është organ drejtues në shkollë dhe në të janë anëtarë përfaqësuesit e të gjitha strukturave të sipërpërmendura. Duke marrë parasysh atë se njëri prej roleve të tij është të aprovojë Programin zhvillimor të shkollës, rekomandohet që anëtarët e tij të mos jenë anëtarë të ekipit/komisionit për hartimin e programit. Këshilli shkollor ka rol specifik në gjithë procesin e planifikimit zhvillimor dhe avancimit të shkollës dhe roli i tij është përshkruar në kapitullin e radhës.

## 3.2. Roli i secilit prej faktorëve

### 3.2.1. Drejtoria shkollore

Drejtoria shkollore (drejtori dhe ndihmës drejtori i shkollës) është përgjegjës për udhëheqjen e procesit të zhvillimit, respektivisht për sigurimin e planifikimit të suksesshëm dhe zbatimin e tij.

**Në procesin e hartimit të Programit zhvillimor të shkollës**, drejtorja e shkollës kujdeset që i njëjti t'i reflektojë karakteristikat e shkollës dhe bashkësisë vetanake, të jetë i bazuar në të dhëna dhe dëshmi, t'i reflektojë nevojat dhe mundësitë e shkollës dhe aktivitetet e parashikuara me programin të jenë në përputhje me vizionin dhe misionin e shkollës.

Është detyrim i drejtorisë shkollore që t'i përfshijë të gjitha palët e interesuara në hartimin dhe zbatimin e Programit zhvillimor të shkollës, si dhe të sigurojë mbështetje për realizimin e qëllimeve dhe aktiviteteteve nga të gjithë faktorët.

**Në procesin e realizimit të Programit zhvillimor të shkollës** drejtorja shkollore i siguron udhëzimin, mbështetjen, dhe resurset e nevojshme për zbatimin e aktiviteteteve të planifikuara dhe kujdeset për zbatimin përkatës të planit, gjë që mund të përfshijë: alokimin e resurseve dhe kuadrit për mbështetjen e implementimit, ndjekjen e përparimit ndaj qëllimeve të vendosura dhe dhënien e mbështetjes dhe informacionit kthyes të kuadrit shkollor, adekuat me nevojat.

Drejtorja ka rol të rëndësishëm edhe në **ndjekjen e realizimit të Programit zhvillimor të shkollës** dhe efekteve nga aktivitetet e zbatuara, përmes ndjekjes së kualitetit të mësimin, ndjekjen e arritjeve të nxënësve, komunikimit me palë të ndryshme të interesuara për mbledhjen e informacioneve për efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e planit. Në këtë mënyrë, mund të sigurohet se përmes realizimit të asaj që është planifikuar arrihen rezultatet e pritura.

Roli i drejtorisë shkollore në përgatitjen dhe realizimin e Programit zhvillimor të shkollës lëvizë, kryesisht, në domenet si vijon: udhëheqje, liderizëm dhe mbështetje.

### 3.2.2. Këshilli shkollor

Roli i këshillit shkollor në planifikimin dhe realizimin e programit zhvillimor të shkollës është që të sigurojë mbështetje dhe llogaridhënie në mënyrë që të sigurohet se programi është në përputhje me qëllimet dhe prioritetet lokale dhe se i reflekton nevojat e të gjithë faktorëve. Duke marrë parasysh

përbërjen e këshillit shkollor, ai duhet të jetë lidhja e shkollës me të gjitha palët e prekura dhe të mundësojë komunikim aktiv me të njëjtat.

**Në procesin e hartimit të programit zhvillimor të shkollës** këshilli shkollor duhet të ofrojë udhëzime dhe mbështetje të ekipit shkollor në raport me atë nëse plani është harmonizuar me politikat kombëtare dhe lokale arsimore si dhe me buxhetin e arritshëm shkollor dhe resurset. Me këtë rast, anëtarët e ndryshëm të këshillit mund të kontribuojnë duke bërë të ditura politikat dhe praktikat efektive.

**Në procesin e realizimit të programit zhvillimor të shkollës**, këshilli shkollor është përgjegjës të kujdeset për zbatimin efektiv e të njëjtit. Kjo mund të përfshijë sigurimin e resurseve dhe mbështetjes së shkollave dhe kuadrit shkollor për mundësimin e realizimit të planit, ndjekjen e arritjes së qëllimeve, identifikimin e pengesave potenciale për realizim, dhënie të propozimeve për përshtatjen e aktiviteteve dhe sigurimin e mbështetjes nga komuna.

**Në procesin e ndjekjes së realizimit të programit zhvillimor të shkollës**, këshilli shkollor mund të bëjë pasqyrë të raporteve për avancimin, analizën e indikatorëve të ndryshëm, si për shembull arritjet e nxënësve, klima shkollore etj., të japë informacion kthyes për shkallën e arritjes së qëllimeve dhe udhëzime për përshtatje potenciale të planit në mënyrë që të sigurohet se shkolla avancohet në mënyrë të vazhdueshme.

Roli i këshillit shkollor në përgatitjen dhe realizimin e Programit zhvillimor të shkollës lëvizë, kryesisht, në domenet si vijon: miratim të programi, mbështetje dhe llogaridhënie.

### 3.2.3. Kuadri edukativo-arsimor shkollor

Kuadri edukativo-arsimor shkollor (mësimdhënës, bashkëpunëtorë profesionalë) ka rol thelbësor në planifikimin dhe realizimin e programit zhvillimor të shkollës. Ai është përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve dhe realizimin e qëllimeve dhe burim i informacioneve për zbatimin dhe efektivitetin e programit.

**Në procesin e hartimit të programi zhvillimor të shkollës**, kuadri edukativo-arsimor mund të kontribuojë me përvojën dhe profesionalizmin e vet përmes shpërndarjes së informacioneve për aspektet që funksionojnë mirë në klasën dhe shkollën dhe atyre që duhet të përmirësohen. Po ashtu, mund të japë informacion kthyes për qëllimet dhe aktivitetet konkrete që parashikohen, si dhe propozimet për idetë dhe ose përshtatjet plotësuese të aktiviteteve.

**Në procesin e realizimit të programit zhvillimor të shkollës**, kuadri edukativo-arsimor është përgjegjës për realizimin e aktiviteteve dhe arritjen e qëllimeve (për shembull: ndryshim në qasjet në mësimin, dhënie të mbështetjes plotësuese për nxënësit me vështirësi në nxënien dhe ngjashëm).

**Në procesin e ndjekjes së realizimit të programit zhvillimor të shkollës**, kuadri edukativo-arsimor mbledhë të dhëna për arritjet e nxënësve dhe për indikatorët tjerë, e ndjekë përparimin gjatë periudhës së caktuar kohore dhe jep informacione për arritjen e qëllimeve. Në këtë mënyrë, mësimdhënësit dhe shërbimi profesional janë në gjendje që të ndjekin vazhdimisht nëse procesi zbatohet në mënyrë përkatëse dhe në drejtim të realizimit të nevojave të nxënësve dhe arritjen e rezultateve të dëshiruara.



Kuadri edukativo-arsimor është partner kyç në të gjitha fazat (planifikim, zbatim, ndjekje) të Programit zhvillimor të shkollës për arsye se me ndërlidhjen e profesionalizmit dhe përvojës së tyre kujdeset që aktivitetet të jenë relevante, të realizueshme dhe përkatëse me nevojat e nxënësve.

Roli i kuadrit edukativo-arsimor në përgatitjen dhe realizimin e Programit zhvillimor të shkollës lëvizë, kryesisht, në domenet si vijon: profesionalizëm, implementim, ndjekje, ndërsa përfshirja e tij bëhet kryesisht përmes Këshillit të mësimdhënësve dhe ekipeve të formuara nga shkolla.

#### 3.2.4. Nxënësit

Veçanërisht është e rëndësishme që nxënësit të jenë të përfshirë në planifikimin dhe realizimin e Programit zhvillimor të shkollës, për arsye se te ata krijon ndjenjën e përkatësisë, pjesëmarrjes dhe përgjegjësisë, e njëherësh e rritë motivimin dhe kujdesin e tyre për shkollën.

Nxënësit, përmes organeve të tyre (bashkësitë e nxënësve në nivel të paraleles dhe Parlamentit të nxënësve) kanë rol kyç në dhënien e informacioneve për nevojat dhe përvojat e tyre dhe për atë nëse Programi zhvillimor i shkollës i reflekton perspektivat dhe prioritetet e tyre.

**Në procesin e hartimit të programit zhvillimor të shkollës** nxënësit mund të ofrojnë informacione të rëndësishme rreth asaj se çfarë funksionon mirë në shkollë dhe cilat janë nevojat për ndryshim. Veçanërisht e rëndësishme është përfshirja e tyre në:

1. Vlerësimin e gjendjes dhe nevojave në kuadër të vetevaluimit të shkollës. Parlamenti i nxënësve mund të përfshihet përmes mbledhjes së të dhënave për gjendjes ekzistuese të shkollës, përmes zbatimit të anketave, diskutimeve në fokus grupe ose forma të tjera për konsultime. Në këtë mënyrë nxënësit mund të ofrojnë shqyrtim në fushat që kanë të bëjnë me mësimin, klimën shkollore, arritjet dhe pjesëmarrjen e tyre.
2. Procesin e seleksionimit të prioritetëve për përmirësim, me ç'rast Parlamenti i nxënësve, në emër të nxënësve, do të prononcohet se cilat prioritete konsiderojnë se janë veçanërisht të rëndësishme për ta.
3. Planifikimin e aktiviteteve në planet e veprimit. Me përfshirjen e nxënësve në planifikimin e aktiviteteve sigurohet relevantë e aktiviteteve të nevojave të nxënësve dhe shanse më të mira për sukses. Ata, po ashtu, mund të japin propozime për aktivitete konkrete për përmirësimin e mësimin dhe nxënies.

**Në procesin e realizimit të programit zhvillimor të shkollës** organet e nxënësve mund të ndihmojnë në implementimin përkatës, përmes shpërndarjes së informacioneve për funksionalitetin, efektivitetin, ndarjen e sfidave ose pengesave dhe propozimin e përshtatjeve.

**Në procesin e ndjekjes së realizimit të programit zhvillimor të shkollës**, nxënësit mund të kenë rol të rëndësishëm nga aspekti i asaj se si aktivitetet e zbatuara reflektohen në përvojat me nxënien, nëse qëllimet e parashikuara janë arritur dhe të japin rekomandime dhe ide të tyre për përshtatje dhe/ose përmirësim.

Në këto mënyra sigurohet përfshirjen e zërit të nxënësve dhe tregohet kujdes për interesat dhe nevojat e tyre. Kështu, shkolla i vendosë nxënësit në qendrën e intervenimeve të tyre dhe e përmirëson mjedisin për nxënie.

### 3.2.5. Prindërit

Përfshirja e prindërve në planifikimin dhe realizimin e Programit zhvillimor të shkollës mundëson ndarjen e kujdesit dhe përgjegjësisë për cilësinë e arsimit të fëmijëve të tyre. Prindërit mund të jenë të përfshirë përmes organeve të tyre (këshilli i prindërve në nivel të paraleles dhe këshillit të prindërve në nivel të shkollës), por edhe si individë.

**Në procesin e përpilimit të programit zhvillimor të shkollës** prindërit po ashtu mund të ndajnë informacione të rëndësishme për atë që funksionon mirë në shkollë dhe çfarë është ajo që do të donin që të përmirësohet, me propozime të tyre se si do të bëhej kjo në mënyrën në të cilën do të japë efekte.

**Në procesin e realizimit të programit zhvillimor të shkollës** prindërit mund të përfshihen në realizimin e një pjese të aktiviteteve, veçanërisht atje ku prania e tyre paraqet mbështetje të procesit arsimor dhe të klimës në shkollë.

**Në procesin e ndjekjes së realizimit të programi zhvillimor të shkollës** prindërit mund të përfshihen në vlerësimin e suksesit të realizimit të aktiviteteve. Informacioni kthyes nga prindërit është veçanërisht i çmueshëm për planifikimin e intervenimeve të mundshme në Programin zhvillimor të shkollës, me qëllim të arritjes së qëllimeve të planifikuara.

### 3.2.6. Vetëqeverisja lokale

Përfshirja e vetëqeverisjes lokale është një nga faktorët e rëndësishëm për suksesin e Programit zhvillimor të shkollës dhe aktiviteteve për avancimin e tij. Përfaqësues nga vetëqeverisja lokale është anëtar i Këshillit shkollor dhe me këtë është tashmë i përfshirë në procesin, por, duke marrë parasysh rëndësinë e pjesëmarrjes së vetëqeverisjes lokale në thuajse të gjitha fazat e përpilimit, realizimit dhe ndjekjes së Programit zhvillimor të shkollës, është e domosdoshme pjesëmarrja edhe e anëtarëve të tjerë të vetëqeverisjes lokale, veçanërisht nga Sektori me kompetencë për arsimin.

**Në procesin e përpilimit të programit zhvillimor të shkollës,** vetëqeverisja lokale duhet të punojë së bashku me shkollat në vendosjen e prioriteteve dhe qëllimeve për përmirësim. Kjo mund të zbatohet përmes mbledhjes së ideve nga bashkësia lokale lidhur me çështjet kyçe që e prekin arsimin në komunë dhe ndërtimin e vizionit të përbashkët. Vetëqeverisja lokale mund të ofrojë edhe udhëzime dhe mbështetje teknike të shkollës për planifikimin e suksesshëm. Për shembull, gjatë planifikimit, mund të japë rekomandime për praktika që janë treguar si efikase në shkolla të tjera, të shpërndahen resurse dhe njohuri profesionale për fusha të caktuara dhe të ndihmohet në identifikimin e mundësive për bashkëpunim dhe partneritet.

**Në procesin e realizimit të programit zhvillimor të shkollës,** vetëqeverisja lokale duhet të sigurojë mjete për mbështetje të një pjese të qëllimeve për avancimin e shkollës, përmes granteve ose llojeve të tjera të mbështetjes financiare të shkollës, si dhe koordinim me agjenci dhe organizata të tjera për sigurimin e mjeteve dhe resurseve. Komuna, në planifikimin e saj vjetor të buxhetit do të duhej të përfshijë një pjesë të prioriteteve që janë të definuara në Programet zhvillimore të shkollave në kompetencë të saj.

Në këtë mënyrë do të sigurohet ndërlidhje buxhetore ndërmjet shkollave dhe komunës për fusha me interes të përbashkët.

**Në procesin e ndjekjes së realizimit të programit zhvillimor të shkollës,** vetëqeverisja lokale duhet ta ndjekë arritjen e qëllimeve dhe të kërkojë llogaridhënie nga shkolla lidhur me përparimin gjatë zbatimit të aktiviteteve dhe arritjes së qëllimeve. Komuna mund të bëjë të ditura të sfidave dhe pengesave potenciale për realizimin e qëllimeve dhe të propozojë përshtatje potenciale të aktiviteteve. Në këtë mënyrë kujdeset që qëllimet e Programit zhvillimor të shkollës u përgjigjen nevojave të bashkësisë.

Roli i vetëqeverisjes lokale në përgatitjen dhe realizimin e Programit zhvillimor të shkollës lëvizë, kryesisht, në domenet si vijon: mbështetje, llogaridhënie, resurse.


### 3.2.7. Bashkësia lokale, organizatat qytetare, institucionet me të cilat bashkëpunon shkolla

Bashkësia lokale mund të ketë rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin dhe ndjekjen e PZSHSH përmes:

1. Dhënies së kontributit të saj për të bërë të ditura anët e forta dhe sfidat e shkollës. Ata mund t'i shpërndajnë perspektivat e tyre për aspektet në të cilat shkolla është mirë dhe do të duhej të jenë më të mirë, në bazë të përvojave me shkollën dhe njohjen e bashkësisë.
2. Mbështetjes në realizimin, përmes angazhimit për prioritete të caktuara para komunës ose institucioneve kombëtare arsimore. Në të njëjtën kohë, përfaqësues të bashkësisë mund të përfshihen si vullnetarë në realizimin e aktiviteteve të caktuara ose sigurimin e resurseve në drejtim të arritjes së qëllimeve nga programi.
3. Ndjekje të përparimit ndaj qëllimeve të vendosura në Programin zhvillimor të shkollës, dhënie të informacioneve kthyesë për efektivitetin e aktiviteteve të caktuara dhe orientim në fusha për të cilat mund të jepet mbështetje plotësuese.

## 4. Fazat dhe hapat në hartimin dhe realizimin e Programit zhvillimor të shkollës

Foto 1. Fazat në hartimin e Programit zhvillimor të shkollës



### 4.1. Faza e përgatitjes (para planifikimit)

Faza e përgatitjes përfshin kontrollin/revizionin ose diagnozën e gjendjes. Diagnoza e gjendjes është e rëndësishme për arsye se e paraqet gjendjen momentale reale të shkollës. Duke marrë parasysh faktin se proceset e vetevaluimit dhe planifikimit zhvillimor janë të ndërlidhura, gjatë kësaj faze është i domosdoshëm bashkëpunimi i drejtpërdrejt dhe konsultimet mes ekipit/komisionit për zbatimin e vetevaluimit dhe ekipit/komisionit për hartimin e programit zhvillimor të shkollës.

#### 1. Vlerësim i situatave (përcaktim i gjendjes momentale) – zbatim i vetevaluimit të shkollës

Hapi i parë gjatë hartimit të programit zhvillimor të shkollës është analiza e gjendjes ose paraqitja e saktë e gjendjes së shkollës. Analiza bën të ditur në problemet dhe pikat kritike që duhet të trajtohen në mënyrë adekuate në ciklin e ri të planifikimit zhvillimor të shkollës. Është e mundur që analiza e gjendjes të tregojë shkallë të pamjaftueshme të realizimit të qëllimeve në raport me planifikimin

paraprak zhvillimor me ç'rast do të detektohen arsyet për këtë. Po ashtu, analiza mund të bëjë të ditur në ndikimin e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në pikat e evidentuara të dobëta të shkollës.

Për shembull, në mënyrë që të mësojmë për arsyet e vërteta për uljen e numrit të nxënësve në shkollë ose për braktisjen e tyre të shkollës, përveç faktorëve të brendshëm, analizohen edhe ata që janë të faktorë të jashtëm, respektivisht shoqëroro-ekonomik. Prandaj, deri në fillim të planifikimit zhvillimor të ardhshëm duhet të sigurohen informacionet e nevojshme për mënyrën e funksionimit të shkollës dhe të njëjtat të vihen në dispozicion të të gjithë faktorëve në procesin.

Me zbatimin e vetevaluimit shkolla duhet t'i vlerësojë arritjet vetanake ndaj indikatorëve të ndryshme, t'i identifikojë anët e fuqishme dhe dobësitë e shkollës dhe t'i përcaktojë fushat në të cilat puna e saj duhet të avancohet.

**Rolet e faktorëve:** Kuadri edukativo-arsimor dhe drejtoria shkollore kryesojnë procesin, derisa nxënësit, prindërit dhe përfaqësuesit e bashkësisë japin informacione kthyesë dhe sugjerime nga aspekti i perspektivës së tyre.

## 2. Formimi i komisionit për hartimin e Programit zhvillimor të shkollës

Për hartimin e programit zhvillimor është përgjegjës një rreth i caktuar i njerëzve, por gjatë krijimit të saj duhet të konsultohen të gjitha subjektet që ndikojnë ose janë të përfshira drejtpërdrejt në punën e shkollës. Për këtë qëllim drejtori i shkollës formon komision të veçantë, me ç'rast rekomandohet procesin e hartimit të programit zhvillimor të shkollës ta udhëheqin drejtori i shkollës, mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesional, ndërsa gjatë gjithë procesit të hartimit të programit zhvillimor të jenë të konsultuar vazhdimisht përfaqësuesit e këshillit të prindërve, parlamentit të nxënësve, këshillit shkollor dhe vetëqeverisjes lokale.

## 3. Analizë e rezultateve nga vetevaluimi dhe evaluimi integral i shkollës - SWOT analiza – anë të forta, anë të dobëta, mundësi, barriera

Analizat e rezultateve nga vetevaluimi dhe evaluimi integral i shkollës japin një pasqyrë për funksionimin e shkollës, anët e saj të forta, anët e dobëta dhe resurset shikuar nga kënde të ndryshme (të punësuar, nxënës, përfaqësues të bashkësisë lokale) në të gjitha fushat e punës së shkollës. Analiza është parakusht për identifikimin e nevojave të shkollës dhe mundëson identifikimin dhe definimin e prioritetëve për zhvillim dhe avancim të shkollës.

Për këtë qëllim, në bazë të analizave paraprake, bëhet SWOT analizë, që paraqet kornizë analitike për marrjen e informacioneve relevante për shkollën dhe mjedisin në të cilin ajo funksionon. Ajo mundëson:

- Identifikimin e anëve të forta me qëllim që të forcohen.
- Identifikimin e anëve të dobëta me qëllim që të largohen.
- Shqyrtimin e mundësive për shfrytëzim optimal të të gjithë faktorëve dhe resurseve.

- Analiza e rreziqeve (kërcënimet, pengesat) me qëllim që të njëjtat të paralajmërohen ose minimizohen.

<p><b>Përparësitë (anët e forta) e shkollës</b></p> <p>Anët e forta, potencialet e një shkolle i paraqesin rezultatet që janë arritur me përdorimin efektiv të resurseve njerëzore dhe materiale. Në këtë fushë duhet të fokusohemi në sukseset në shkollë, në atë që në të funksionon mirë dhe për çka ajo dallohet, respektivisht të përmenden faktorët e brendshëm të cilët janë dalluar si përparësi e shkollës. Kjo rezulton nga përgjigjet në pyetjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Cilat janë përparësitë e shkollës sonë?</li> <li>- Çfarë të mire të bëjmë?</li> <li>- Cilat janë sukseset tona që i shikojnë të tjerët?</li> </ul>	<p><b>Dobësi (anë të dobëta) të shkollës</b></p> <p>Anët e dobëta të një shkolle kanë të bëjnë me dështimin dhe arritjen e rezultateve të dobëta në domene të ndryshme të punës së tij, respektivisht në gjithë atë që është detektuar se funksionon në mënyrë joadekuate në shkollë dhe në çka duhet të kushtohet vëmendje e veçantë gjatë planifikimit. Identifikimi i tyre mundëson që shkolla të përqendrohet në gjetjen e strategjive për mënjanimin e të njëjtave. Këtu duhet të përmenden faktorët e brendshëm që dëmtojnë zhvillimin e shkollës, ndërsa rezulton nga përgjigjet ndaj pyetjeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Çfarë nuk bëjmë ashtu siç duhet?</li> <li>- Çfarë duhet të përmirësojmë?</li> <li>- Çfarë është ajo që duhet ta hedhim poshtë, respektivisht ta ndryshojmë në punën tonë?</li> </ul>
<p><b>Mundësi (rrethana) që rezultojnë nga shkolla dhe mjedisi</b></p> <p>Kjo fushë ka të bëjë me mundësitë që shkolla dhe mjedisi i ofron/posedon, e që mund të shfrytëzohen për zhvillimin e shkollës. Duhet të përmenden faktorët që mund të ndihmojnë në punën e shkollës, respektivisht të përgjigjet në pyetjen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Cilat mundësi ekzistojnë, ndërsa janë adekuate për t'i shfrytëzuar në procesin e avancimit të shkollës?</li> </ul>	<p><b>Kërcënime, pengesa (rreziqe) që rezultojnë nga shkolla dhe mjedisi i saj</b></p> <p>Kjo fushë ka të bëjë me pengesat e jashtme që ndikojnë në punën e shkollës. Duhet të përmenden faktorët e jashtëm që dëmtojnë zhvillimin e shkollës, ndërsa rezulton nga përgjigjet në pyetjen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Cilat pengesa ekzistojnë dhe realisht mund të ndikojnë në procesin e avancimit të shkollës?</li> </ul>

SWOT analiza është platformë për kufizimin e prioriteteve, qëllimeve strategjike, qëllimeve dhe aktiviteteve zhvillimore. Planifikimi në fakt duhet të japë përgjigje për atë se si shkolla do t'i shfrytëzojë anët dhe mundësitë e saj të forta, si dhe mundësitë që i ofron mjedisi i tij, në mënyrë që t'i përmirësojë anët e saj të dobëta dhe t'i tejkalojë pengesat që ndikojnë në zhvillimin e tij.

<b>Shembull për SWOT analizë:</b>	
<p><b>Përparësitë (anët e fuqishme) të shkollës</b> <i>Shembull:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ekziston bashkëpunim i hapur dhe shkëmbim i përvojave dhe informacioneve gjatë planifikimit dhe realizimit të procesit mësimor në nivel të ndryshëm në kuadër të shkollës.</li> <li>- Përparimi dhe arritjet e nxënësve ndiqen përmes notimit formativ dhe sumativ. Sipas nxënësve dhe prindërve notimi është transparent, i vazhdueshëm dhe i drejtë.</li> <li>- Për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore shërbimi profesional realizon mbështetje të organizuar individuale në aspektin e zhvillimit dhe forcimit të funksionaliteteve të tyre, që paraqet forcim të kapaciteteve të tyre për procesin e nxënies;</li> <li>- Shkolla kujdeset rregullisht për shëndetin e nxënësve, në shkollë ekziston Procedurë për përkujdesjen e nxënësve me probleme me shëndetin, sëmundje kronike dhe lëndime më të rënda që është pranuar përgjithësisht dhe është zbatuar nga nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit dhe është pjesë e kulturës së shkollës.</li> <li>- Pjesë e kulturës shkollore është edhe qasja humane ndaj të gjithë atyre të cilëve u nevojitet ndihmës përmes organizimit dhe zbatimit të aksioneve humanitare me qëllim të ngritjes së vetëdijes te nxënësit për respektin e ndërsjellë dhe barazinë, ndjeshmërinë dhe sjelljen e padhunshme dhe zgjidhjen e konflikteve .</li> </ul> <p>.....</p>	<p><b>Dobësitë (anët e dobëta) të shkollës</b> <i>Shembull:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mjete të pamjaftueshme didaktike që nevojiten për realizimin më të suksesshëm dhe me kohë të programeve mësimore.</li> <li>- Resurse të pamjaftueshme për mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.</li> <li>- Nxënësit arrijnë rezultate të dobëta nga lënda e matematikës, veçanërisht në klasën e gjashtë.</li> <li>- Nxënësit ende nuk ndjehen mjaft të angazhuar në planifikimin e aktiviteteve dhe vendimmarrjen në shkollë.</li> <li>- Përfshirje e pamjaftueshme e prindërve në aktivitete, edukime dhe punëtori të përbashkëta.</li> <li>- Shkolla ka zhvilluar sistem të sendërtimit dhe lëvdatës të nxënësve, megjithatë prindërit konsiderojnë se ky sistem duhet të përsoset.</li> <li>- Dy qëllime zhvillimore: ..... nga Programi i deritanishëm zhvillimor i shkollës nuk janë realizuar tërësisht</li> </ul> <p>.....</p>
<p><b>Mundësi (raste) që rezultojnë nga shkolla dhe mjedisi</b> <i>Shembull:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shkolla ka hapësirë që është adekuate për pajisje me dhomë sensorike</li> <li>- në shkollë ka kuadër që mund të ushtrojë diseminacion të trajnimeve</li> <li>- bashkëpunimi me OJQ për ngritjen e cilësisë së</li> </ul>	<p><b>Kërcënime, pengesa (rreziqe) që rezultojnë nga shkolla dhe mjedisi i saj</b> <i>Shembull:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Angazhimi i madh i prindërve me detyrime punuese dhe të përditshme pamundëson përfshirjen e tyre më të madhe në punën e shkollës.</li> <li>- Angazhim i pamjaftueshëm i bashkësisë për</li> </ul>

proceseve inkluzive në shkollë - bashkëpunim me Qendrën e resurseve - përfshirje të sektorit lokal publik si mbështetje e aktiviteteve të shkollës .....	sigurimin e kushteve më të mira për punën e shkollës. - Disa ndikime të caktuara nga bashkësia mund të cenojnë objektivitetin në notimin e nxënësve .....
---	---

**Roli i faktorëve:** SWOT analizën e bëjnë ekipi (komisioni) për vetevaluim të shkollës dhe ekipit (komisionit) për programin zhvillimor të shkollës, duke i përdorur analizat nga vetevaluimi dhe evaluimi integral i shkollës.

## 4.2. Faza e planifikimit

Planifikimi është fazë gjatë së cilës shkolla i sistematizon të gjitha informacionet nga faza paraprake në një varg logjik të qëllimeve dhe aktiviteteve që duhet të ndërmerren në të ardhmen. Në këtë fazë përkufizohen misioni dhe vizioni i shkollës, bëhet seleksionimi i prioriteteve, përkufizohen qëllimet strategjike dhe zhvillimore dhe hartohen plane të veprimit për realizimin e tyre.

### 1. Përkufizimi i misionit dhe vizionit të shkollës

Procesi i përkufizimit të misionit dhe vizionit të shkollës siguron kontinuitetin e misionit dhe vizionit tashmë ekzistues, jep drejtimin në të cilin do të lëvizë shkolla, bën të ditur në nevojat e vendosjes së ndryshimeve, nxitë interes dhe hapje ndaj zgjidhjeve kreative, ndërton besim, lojalitet dhe stimulon punën ekipore. Duke marrë parasysh faktin se qëllimi i procesit të zhvillimit të shkollës është ajo se vazhdimisht ndryshohet dhe avancohet, ndryshohen edhe deklaratat për misionin dhe vizionin e shkollës. Ajo që shkolla ka qenë katër vite më parë, pritet që me procesin e zhvillimit të tij të ndryshohet dhe të kemi pasqyrë të re për atë se si është shkolla tani, katër vite më pas nga intervenimet, respektivisht të arrihen një pjesë ose të gjitha nga ndryshimet e dëshiruara që i kemi pasur në deklaratën për vizionin e shkollës. Në deklaratën e re për misionin shihet se si është shkolla tani, derisa në deklaratën e re për vizionin e shkollës e përshkruan projeksionin për atë se si dëshiron të duket shkolla pas ciklit të ri të zhvillimit, me çka kjo në fakt vazhdimisht ndryshohet dhe avancohet. Deklaratat për misionin dhe vizionin duhet të shpërndahen, mbështeten dhe pranohen nga të gjithë faktorët.

**Misioni** i shkollës ka të bëjë me qëllimin e ekzistimit të shkollës dhe në të janë përfshirë vlerat rrënjësore, besimet, pritjet dhe interesat e subjekteve kyçe në procesin edukativo-arsimor. Përmes deklaratës për misionin, në fakt, fitohet pasqyrë për atë se cila është shkolla, çfarë ofron dhe çfarë bën. Në të janë përfshirë përgjigjet e pyetjeve:

- Cila është shkolla?
- Pse ekziston?
- Cilat janë parimet kryesore të reja?
- Cilat janë vlerat kyçe të saj?
- Cili është qëllimi kryesor i saj?



Deklaratë për misionin duhet të jetë:

- Konkrete
- Konkize
- E shkurtër
- E kuptueshme
- Reflekton specifikat e shkollës
- Sjell porosi që frymëzon dhe nxitë
- Është e orientuar drejt rezultateve dhe arritjeve
- Lehtë për t'u mbajtur mend

#### **Shembull për misionin:**

Ne jemi shkollë që i edukon nxënësit të ndërtojnë vlera të mirëfillta dhe të përhershme në jetë, t'i respektojnë dhe përmbushin të drejtat dhe detyrimet qytetare, të respektojnë kulturën vetanake dhe kulturën e bashkësive të tjera etnike në Republikën e Maqedonisë dhe të jetojnë në frymën e paqes, tolerancës dhe respektit të ndërsjellë.

Ne krijojmë mjedis të shëndetshëm dhe të sigurt për të gjithë nxënësit tanë. Në mënyrë të vazhdueshme e ndjekim secilin nxënës nga secili aspekt (arsimor, emocional, social) duke marrë parasysh respektimin e dallimeve individuale dhe duke mundësuar zhvillim optimal të secilit prej tyre.

**Vizioni** i shkollës paraqet projeksion të së ardhmes, pasqyrë të dëshiruar të shkollës ndaj së cilës synon ajo. Ajo e jep përgjigjen e pyetjes se si duhet të jetë shkolla për periudhë të caktuar kohore.

Deklarata për vizionin duhet të jetë:

- E shpërndarë
- Reale, e realizueshme
- E kufizuar në aspektin kohor
- Konkize dhe konkrete
- Sfiduese
- E udhëzuar

#### **Shembulli për vizionin:**

Synimi ynë është që të jemi shkollë që do të ndërtojë personalitete të shëndetshme dhe të përgjegjshme dhe që do t'u mundësojë nxënësve të saj përvetësimin e njohurive dhe shkathtësive me ndihmën e mjeteve bashkëkohore mësimore dhe qasje bashkëkohore dhe të ndryshme në mësimin, si dhe mbështetje të përhershme në aspekte të ndryshme të jetës së tyre.

Duam të jemi shkollë në të cilën të gjithë nxënësit tanë dhe prindërit e tyre do të ndjehen të mirëseardhur, të përfshirë dhe të respektuar.

#### **Shembulli për vizion:**

Vizioni ynë është që nxënësit ta mbarojnë shkollën me:

- **Vlera të miratuara morale** – ndershmëri, integritet dhe gjykim të drejt.
- **Shkathtësi të zhvilluara bazike** – gjuhësore, matematikore, shkencore, artistike, fizike dhe sociale
- **Mendje të hapur dhe dëshirë për dituri**
- **Vetëbesim të fortë dhe pritje të larta vetanake**
- **Tolerancë dhe respektim i të tjerëve**

Ne e vlerësojmë partneritetin që ekziston ndërmjet shkollës, prindërve dhe bashkësisë dhe kjo kontribuon në realizimin e vizionit tonë.

## 2. Identifikimi dhe seleksionimi i prioriteteve

Prioritetet rezultojnë nga anët e dobëta dhe nevojat e shkollës dhe identifikohen në kuadër të çdo fushe nga puna e shkollës që në fazën e vetevaluimit, duke marrë parasysh rëndësinë e tyre për zhvillimin e shkollës nga aspekti i të gjithë faktorëve kontekstualë, specifikave të shkollës, resurseve financiare dhe njerëzore.

Është e zakonshme që lista e nevojave të përcaktuara të jetë dukshëm e gjatë, por është reale se në periudhë të caktuar nuk mund të ndryshojmë gjithçka që duam të ndryshojmë. Në fakt, nëse duam të ndryshojmë gjithçka, nuk do të ndryshojmë asgjë. Prandaj, është me rëndësi të veçojmë atë që është më e nevojshme për shkollën, respektivisht të seleksionohen prioritetet që janë në kuadër të listës së përcaktuar të nevojave.

Në procesin e seleksionimit veçohen 3-5 prioritate që rezultojnë nga SWOT analiza, misioni dhe vizioni, me ç'rast shkolla duhet të udhëhiqet nga disa kriteret, me çka do të mund t'u japë përparësi disa prioritetet në raport me të tjerat:

- **Sa është lidhshmëria e prioritetet me nevojat e shkollës dhe bashkësisë?** Ekipi shkollor duhet të ketë qasje në nevojat e faktorëve të ndryshëm, veçanërisht të nxënësve, në mënyrë që të mund të përcaktojë se cilat prioritate u konvenojnë më së miri nevojave të tyre. Për këtë qëllim, rekomandohet gjatë përkufizimit të prioriteteve që të përfshihen përfaqësues të faktorëve të ndryshëm, në mënyrë që t'i prezantojnë nevojat e grupeve që i përfaqësojnë.

- **Sa është e lidhur drejtpërdrejt ose tërthorazi me përmirësimin e arritjeve dhe mirëqenies së përgjithshme të nxënësve?** Duke marrë parasysh se qëllimi përfundimtar i procesit arsimor është realizimi i potencialeve të nxënësve nga aspekti i arritjeve shkollore dhe mirëqenies së përgjithshme, gjatë përcaktimit të fushave parësore duhet pasur kujdes që ato të shpijnë drejt arritjes së këtyre qëllimeve.

- **Sa është emergjent intervenimi i lidhur me prioritetin?** Për disa prioritate ka nevojë për intervenim më emergjent në raport me të tjerët, duke marrë parasysh vlefshmërinë e tyre dhe ndikimin e tyre në punën e shkollës.

- **Sa është i arritshëm realizimi, respektivisht nëse shkolla ka kapacitete të mjaftueshme për implementimin e masës?** Realizimi mund të varet nga resurset e arritshme, kuadrit ekzistues, kornizës kohore, mbështetja e bashkësisë, donatorët lokalë dhe ndërkombëtarë dhe ngjashëm. Të gjithë këta faktorë duhet të merren parasysh gjatë përcaktimit të prioriteteve që do të vendosen në programin.

- **Cilat prioritete janë të lidhura dhe shpijnë drejt realizimit të misionit dhe vizionit të shkollës.** Gjatë përkufizimit të fushave parësore, ekipi duhet të marrë parasysh përcaktimet strategjike të shkollës, të përshkruara në misionin dhe vizionin dhe mënyrën në të cilën prioritetet e përzgjedhura do të kontribuonin drejt arritjes së të njëjtave. Prioritetet e seleksionuara do të duhej të arsyetohen shkurtimisht, me çka do të shihet arsyeshmëria për përzgjedhjen e re. **la vlen të përmendet se madje edhe ato prioritete që janë të karakterit materialo-teknik ose kanë të bëjnë me resurset njerëzore duhet të vihen në funksion të përmirësimit të kualitetit të mësimin, arritjet e nxënësve dhe klimën shkollë, respektivisht të jetë evidente se si realizimi i tyre do të ndikojë në arritjet dhe mirëqenien e nxënësve.**

#### **Shembuj për prioritete të përzgjedhura:**

1. **Prioriteti:** Përmirësim i arritjeve nga matematika te nxënësit e klasës së gjashtë dhe të shtatë.

**Arsyetimi:** Vetevaluimi shkollor tregon se nxënësit e klasës së gjashtë dhe të shtatë kanë vështirës në zotërimin e materialit mësimor të matematikës. Shumica e nxënësve deklarojnë se materiali u është tepër i komplikuar dhe nuk e shikojnë zbatueshmërinë. Prindërit shprehin shqetësimin për suksesin e nxënësve gjatë vazhdimin të arsimit të mesëm për shkak të kompetencave të dobëta.

2. **Prioritet:** Përmirësim i arritjeve nga leximi me të kuptuarit te nxënësit nga klasa e parë deri në klasën e tretë.

**Arsyetim:** Mësimdhënësit janë të shqetësuar se nxënësit nga klasa e parë deri në klasën e tretë nuk i arrijnë rezultatet e dëshiruara në raport me leximin, më konkretisht në pjesën e leximit me të kuptuar, gjë që mund të reflektohet në zotërimin e përmbajtjeve mësimore edhe në kuadër të lëndëve të tjera mësimore.

**Roli i faktorëve:** Kuadri edukativo-arsimor, nxënësit dhe këshilli shkollor janë të përfshirë drejtpërdrejt në vlerësimin e rëndësisë së secilit nga prioritetet dhe përzgjedhjen e tyre, duke marrë parasysh se kanë informacione më relevante për nevojat e shkollës. Përfshirja e Këshillit të shkollës, duke marrë parasysh përbërjen e tij, në fakt mundëson në përzgjedhjen e prioritetëve të marrin pjesë përfaqësues të të gjithë faktorëve. Megjithatë, gjatë përzgjedhjes së prioritetëve duhet të përfshihet drejtpërdrejt edhe përfaqësues tjetër i vetëqeverisjes lokale, konkretisht përfaqësues i Sektorit me kompetencë për arsimin.

### **3. Përkufizimi (vendosja) e qëllimeve strategjike dhe zhvillimore për secilin nga prioritetet e vendosura**

Për secilin nga prioritetet e zhvillimit të shkollës duhet të definohen qëllimet që duhet të arrihen në kuadër të atij prioriteti. **Ndonjëherë disa prioritet mund të grupohen në kuadër të një qëllimi strategjik, me çka në fakt mundësohet qasje gjithëpërfshirëse drejt zgjidhjes së problematikës së ngjashme.** Qëllimet e definuara mirë u përgjigjen pyetjeve cilat ndryshime dhe avancime duam t'i arrijmë, cilat janë rezultatet e pritura nga këto ndryshime dhe si do të ndikojnë ato ndryshime në zhvillimin e shkollës në tërësi. Në përgjithësi, qëllimet e vendosura duhet të rrisin cilësinë e nxënies dhe

mësim, t'i avancojnë arritjet e nxënësve në raport me standardet që duhet t'i arrijnë dhe të mundësojnë nxënie në mjedis të sigurt dhe nxitës.

Secili qëllim duhet të jetë i qartë, i matshëm, i arritshëm, i orientuar drejt arritjes së rezultatit dhe e përcaktuar në aspektin kohor, respektivisht secili qëllim në përkufizimin e vet do të duhej të përfshijë së paku tre nga këto pesë karakteristika.

<b>Shembull: Prej prioriteteve drejt qëllimeve strategjike</b>	
<b>Prioritete</b>	<b>Qëllime strategjike</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përfshirje e nxënësve në planifikimin e aktiviteteve dhe vendimmarrjen në shkollë.</li> <li>- Përfshirje të prindërve në aktivitete të përbashkëta, edukime dhe punëtori.</li> <li>- Bashkëpunim me OJQ për ngritjen e cilësisë së proceseve inkluzive në shkollë</li> <li>- Përfshirje e sektorit publik lokal si mbështetje të aktiviteteve të shkollës</li> </ul>	<p><b>1.</b> Të sigurohet raport i plotë i partneritetit dhe bashkëpunim i hapur me të gjithë faktorët në shkollë dhe jashtë saj.</p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përmirësim i arritjeve nga matematika te nxënësit e klasës së gjashtë dhe të shtatë.</li> <li>- Përmirësim i arritjeve nga leximi me të kuptuar te nxënësit nga klasa e parë deri në të tretën.</li> <li>- Sigurim i përzgjedhjes më të madhe të resurseve dhe materialeve për punë gjatë orëve.</li> <li>- Veprime për motivimin dhe përzgjedhjen e nxënësve që do të marrin pjesë në garat.</li> </ul>	<p><b>2.</b> Përmirësim i arritjeve të nxënësve</p>

Përkufizimi i qëllimeve zhvillimore është sqaruar në pjesën 5 – Struktura e planeve të veprimit në kuadër të Planifikimit zhvillimor të shkollës.

**Rolet e faktorëve:** Drejtoria shkollore, kuadri edukativo-arsimor dhe Këshilli shkollor duhet t'i vendosin qëllimet, në konsultim me nxënësit, prindërit dhe përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale, në mënyrë që të sigurojnë ndërlidhjen e tyre me prioritetet e bashkësisë lokale.

#### 4. **Planifikimi, respektivisht zhvillimi i planit të veprimit – për secilin nga prioritetet, vendosja e qëllimeve strategjike, qëllimeve zhvillimore, aktiviteteve, kornizë kohore, bartës të aktiviteteve, indikatorë për sukses**

Në mënyrë që të realizohen qëllimet e planifikuara në Programin zhvillimor të shkollës zhvillohen plane veprimi që i përmbajnë elementet si vijon:

- qëllimi strategjik
- qëllime zhvillimore në kuadër të qëllimit të dhëna strategjik

- aktivitete përmes të cilave do të realizohet secili qëllim zhvillimor
- indikatorë për sukses për secilin aktivitet
- bartës të aktiviteteve
- korniza kohore për realizimin e secilit aktivitet
- resurset që nevojiten për secilin aktivitet
- instrumente/burime të informacioneve për ndjekjen e indikatorëve

Më hollësisht për procesin e zhvillimit të planit të veprimit – në kapitullin 5: Struktura e planeve të veprimit në kuadër të Planifikimit zhvillimor të shkollës

**Rolet e faktorëve:** Kuadri edukativo-arsimor, drejtorja, prindërit dhe vetëqeverisja lokale mund të kontribuojnë në zhvillimin e strategjive, dhënien e informacionit kthyes dhe propozimit të qasjeve që do të ishin efikase në kontekstin lokal.

Drejtorja e shkollës dhe administrata i përcaktojnë resurset e nevojshme për zbatimin e aktiviteteve. Mësimdhënësit mund të japin kontribut për llojin e resurseve që u janë të domosdoshme për zbatimin e aktiviteteve, derisa prindërit dhe bashkësia lokale të japin kontribut ose mbështetje përmes vullnetarizmit ose donacioneve.

#### 4.3. Faza e realizimit

Kjo fazë nënkupton realizimin e aktiviteteve të planifikuara dhe në të, përveç angazhimit të kuadrit edukativo-arsimor, kërkohet edhe angazhim i plotë i drejtorit të shkollës, duke marrë parasysh faktin se është i domosdoshëm menaxhimi dhe koordinimi i mirë i të gjitha proceseve dhe faktorëve. Kjo fazë nënkupton edhe nivel të lartë të përgjegjësisë nga të gjithë ata që janë përgjegjës për realizimin e aktiviteteve të planifikuara, me ç'rast është jashtëzakonisht e rëndësishme që i gjithë procesi i realizimit të Programit zhvillimor të ndiqet përmes procesit të monitorimit.

##### 1. Implementimi – zbatimi i planit të veprimit, respektivisht realizimi i aktiviteteve të planifikuara

Në fazën e implementimit zbatohen aktivitetet e planifikuara në planin e veprimit, vendosen procedura që do të mundësojnë mbështetje të mësimdhënësve dhe personave të tjerë të përfshirë në aktivitete të caktuara në kuadër të qëllimit zhvillimor.

**Rolet e faktorëve:** Kuadri edukativo-arsimor dhe drejtorja shkollore janë përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve, derisa Këshilli shkollor, prindërit dhe përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale japin mbështetje përmes dhënies së informacionit kthyes dhe ndjekjes së përparimit.

##### 2. Monitorim – ndjekje të realizimit të planit të veprimit dhe arritjes së ndryshimeve të dëshiruara

Monitorimi i programit zhvillimor të shkollës paraqet evaluim formativ, respektivisht mënyrën e kontrollit dhe përcaktimit nëse është duke u realizuar ajo që është planifikuar dhe sa mirë realizohet.

Qëllimi i monitorimit është që në mënyrë sistematike të mblidhen të dhëna, të ndiqet dhe mbikëqyret procesi i implementimit të aktiviteteve të planifikuara dhe të vlerësohet suksesi nga aspekti i arritjes së qëllimeve të definuara strategjike dhe zhvillimore. Monitorimi shpie drejt përshtatjes, plotësimit dhe korigjimit të të gjitha aspekteve të planit të veprimit, nëse përcaktohet nevoja për këtë. Prandaj, është me rëndësi që në procesin e monitorimit të merren përgjigje në pyetjet si vijon:

- A zbatohen aktivitetet e planifikuara dhe a sistemohen dhe përdoren resurset në mënyrë efektive?
- A arrihet përparim në raport me qëllimet e vendosura?
- Si ndikon realizimi i Programit zhvillimor te nxënësit, prindërit, mësimdhënësit dhe bashkësia lokale?

**Rolet e faktorëve:** Drejtoria shkollore, kuadri edukativo-arsimor dhe nxënësit mund të përfshihen në ndjekjen e arritjeve të qëllimeve, ndërsa prindërit dhe këshilli i shkollës mund të japin informacion kthyes për nivelin e arritjes së qëllimeve dhe udhëzime për përshtatje potenciale të planit në mënyrë që të sigurohet se shkolla avancohet në mënyrë të vazhdueshme.

#### 4.4. Faza e vlerësimit – përcaktimi i gjendjes momentale – përgatitja e ciklit të ri të planifikimit


Pas skadimit të katër viteve nga realizimi i programit zhvillimor, e para zbatimit të ciklit të ri të vetevaluimit dhe përgatitjes për Programin e ri zhvillimor, komisioni për përgatitjen, realizimin dhe ndjekjen e Programit zhvillimor të shkollës duhet të deklarohet, respektivisht të përgatisë raport në të cilin duhet të përmendet në çfarë vëllimi janë realizuar qëllimet strategjike dhe zhvillimore (cilat qëllime janë arritur tërësisht, cilat pjesërisht, e cilat nuk janë realizuar), gjë që ka ndikuar në arritjen/mosarritjen e qëllimeve, cilët indikatorë na bëjnë të ditur në suksesin (si e dimë se qëllimet janë arritur) dhe cilat janë rekomandimet që duhet të merren parasysh për planifikimin e ardhshëm zhvillimor.

##### 1. Evaluimi

Faza e evaluimit në fakt paraqet vlerësim të situatave, respektivisht cikël të ri të zbatimit të vetevaluimit të shkollës.

Siç është përmendur më parë, vetevaluimi shërben edhe si mekanizëm kontrolli përmes të cilit ndiqet realizimi i qëllimeve të planifikuara në Programin zhvillimor të shkollës, duke marrë parasysh faktin se ai zbatohet në çdo dy vjet, respektivisht para hartimit të Programit zhvillimor të shkollës, në mes të periudhës së realizimit të Programit zhvillimor dhe në fund të realizimit të Programit zhvillimor (shiko Foto 2).

Foto 2. Cikli i përgatitjes, zbatimi dhe ndjekja e planifikimit zhvillimor



Prandaj është e domosdoshme në procesin e vetevaluimit vëmendje të veçantë t'i kushtohet realizimit të qëllimeve të planifikuara në programin zhvillimor të shkollës, me ç'rast, mes tjerash, vlerësohet në çfarë fushëveprimi ka qenë i mundshëm realizimi i qëllimeve të vendosura që kanë të bëjnë me prioritetet e shkollës, respektivisht nëse të njëjtat janë të realizuara tërësisht, të realizuara pjesërisht ose nuk janë realizuar fare dhe pse.

Kjo mundëson që edhe gjatë realizimit të programit zhvillimor të bëhen intervenime dhe përmirësime të domosdoshme, respektivisht e njëjta të rishikohet me qëllim që të merren rezultatet e pritura dhe të realizohen qëllimet e vendosura strategjike. Me këtë, programi zhvillimor nuk paraqet dokument statik, por gjatë realizimit mund të pësojë ndryshime edhe atë në aspektin e: forcimit të resurseve njerëzore, rishqyrtimin e prioriteteve ose ndryshimin e tyre, ndryshimin e afateve kohore dhe aktivitete të planifikuara. Intervenimet në programin zhvillimor i rrisin gjasat për realizimin e suksesshëm të tij.

Rezultatet nga evaluimi janë bazë për avancimin e mëtejshëm dhe përgatitjen e ciklit të radhës të planifikimit zhvillimor të shkollës.

## 5. Struktura e planeve të veprimit në kuadër të Planifikimit zhvillimor të shkollës

### 1. Qëllimi strategjik

**Qëllimet strategjike** shkolla i formulon si gjendje e dëshiruar e ndryshuar e shkollës e arritur pas periudhës prej katër viteve. Ato janë më të përgjithshme, rezultojnë drejtpërdrejt nga prioritetet dhe i përgjigjen pyetjes: Çfarë duam të arrijmë në periudhën prej katër viteve të ardhshme?

**Shembull për qëllimin strategjik:** Të sigurohet marrëdhënie e plotë partneriteti dhe bashkëpunim i hapur me të gjithë faktorët në shkollë dhe jashtë saj.

### 2. Qëllime zhvillimore në kuadër të qëllimit të caktuar strategjik

**Qëllimet zhvillimore** i paraqesin ndryshimet deri te të cilat duam të vjen në një interval më të shkurtër kohor, janë më specifike dhe i përgjigjen pyetjes: Çfarë duam konkretisht të arrijmë për periudhë më të shkurtër? Për çdo qëllim strategjik parashtrihen disa qëllime zhvillimore.

**Shembull:**

Qëllimi strategjik 1	Qëllime zhvillimore
Të sigurohet marrëdhënie e plotë partneriteti dhe bashkëpunim i hapur me të gjithë faktorët në shkollë dhe jashtë saj.	1.1 Krijim i mekanizmave efikase të bashkëpunimit mes shkollës dhe prindërve me çka do të rritet përfshirja e prindërve në punën e shkollës.
	1.2 Mbështetje e iniciativave të nxënësve për pjesëmarrjen demokratike të nxënësve në punën e shkollës.
	1.3 Planifikim i strategjive për bashkëpunim dhe përfshirje të bashkësisë lokale në aktivitetet e shkollës.

### 3. Aktivitete përmes të cilave do të realizohet secili qëllim zhvillimor

Në mënyrë që të realizohen qëllimet, është e domosdoshme që të përmenden aktivitetet që do të sjellin deri te rezultatet e arritura, respektivisht deri te arritja e secilit qëllim zhvillimor. Ata në fakt paraqesin hapa konkrete që duhet të ndërmerren në mënyrë që të realizohet qëllimi i vendosur.

**Shembull:**

**Qëllimi zhvillimor 1** – Krijimi i mekanizmave efikase të bashkëpunimit ndërmjet shkollës dhe prindërve me çka do të rritet përfshirja e prindërve në punën e shkollës.

**Aktivitete:**



1. Realizimi i 4 punëtorive me prindërit përmes të cilave do të jenë të informuar për të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe do të definojnë fushat e bashkëpunimit në të cilat prindërit do të mund të përfshihen.
2. Organizimi i ditëve të dyerve të hapura në kuadër të të cilave prindërit do të kenë rol aktiv gjatë konceptimit dhe organizimit të aktiviteteve.
3. Përfshirje e prindërve në aksionet shkollore ekologjike dhe humanitare, me ç'rast do të kenë rolin e iniciatorëve dhe realizuesve.

#### 4. Indikatorë të suksesit

Indikatorët janë tregues, markerë, fakte, informacione, nota që shërbejnë qëllimet e vendosura dhe të pritura nga plani i veprimit të përshkruhen në mënyrë të matshme (Shtojca 4. Lloji i indikatorëve). Formulohen si përgjigje në pyetjet:

Formulohen si përgjigje ndaj pyetjeve:

- Si do të dimë nëse ajo që e kemi planifikuar realizohet me të vërtetë?
- Deri në çfarë shkalle realizohet?

#### **Shembull:**

**Aktiviteti 1:** Realizimi i 4 punëtorive me prindër përmes të cilat do të informohen për të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe do të definojnë fushat e bashkëpunimit në të cilat prindërit do të mund të përfshihen.

#### **Indikatorët e suksesit:**

- 350 prindër janë të informuar për të drejtat dhe detyrimet e tyre
- Janë definuar 3 fusha të bashkëpunimit me prindërit

**Aktiviteti 2:** Organizim i ditëve të dyerve të hapura në kuadër të të cilave prindërit do të kenë rol aktiv gjatë konceptimit dhe organizimit të aktiviteteve.

#### **Indikatorët e suksesit:**

- Janë realizuar 5 aktivitete në nivel të shkollës në të cilat prindërit kanë qenë kreatorë dhe realizues të të njëjtave.

**Aktiviteti 3:** Përfshirje e prindërve në aksione humanitare shkollore, me ç'rast do të kenë rolin e iniciatorëve dhe realizuesve.

#### **Indikatorët e suksesit:**

- Janë realizuar 2 aksione humanitare iniciatorët e të cilit kanë qenë prindër.

## **5. Bartësit e aktiviteteve**

Për secilin aktivitet duhet të përmenden personat përgjegjës për zbatimin e të njëjtit, por edhe të gjithë ata që do të jenë të përfshirë në atë aktivitet (institucione, grupe, individë).

## **6. Korniza kohore për realizimin e secilit aktivitet**

Korniza kohore i përgjigjet pyetjes në cilën periudhë do të realizohet aktiviteti i planifikuar. Afatet për përfundimin e aktivitetit duhet të jenë realisht të parashtruara. Në përputhje me kornizën kohore, aktivitetet duhet të reflektohen në çdo Program vjetor të shkollës në periudhën që është përfshirë në Programin zhvillimor.

## **7. Resurse që janë të nevojshme për secilin aktivitet**

Resurset (njerëzore, financiare, materiale dhe të tjera) janë të domosdoshme për realizimin e aktiviteteve dhe për këtë është e nevojshme të identifikohen burimet e resurseve për aktivitet të caktuar, të përcaktohet nëse janë të arritshme dhe nëse mund të bëhen të arritshme.

## **8. Ekipi për ndjekjen e aktivitetit**

Personat përgjegjës për ndjekjen e aktiviteteve duhet të përcaktohen në plane veprimit që janë pjesë e programit zhvillimor, me qëllim që të mund t'i planifikojnë këto aktivitet në programet e tyre vjetore dhe të organizojnë funksionimin e tyre.

## **9. Instrumente/burime të informacioneve për ndjekjen e indikatorëve**

Me qëllim të qasjes së barazuar ndaj ndjekjes së arritjeve të indikatorëve, ekipi duhet të përpilojë instrumente për ndjekje (p.sh. pyetësorë anketues, nëse ndiqen ndryshime në qëndrimet dhe perceptimet, formate për ndjekjen e orës, nëse ndiqen ndryshime në praktikat mësimore) ose të vendosë se cilat dhe çfarë të dhënash do të mbledhë dhe ndjekë në bazë të procedurave rrjedhëse për mbledhjen e të dhënave të shkollës (p.sh. për suksesin shkollor, mungesat, numrin/përqindjen e pjesëmarrjes në aktivitete, etj.). Procesi duhet ta ndjekë dinamikën e parashikuar për ndjekjen e implementimit në planin e veprimit.


### Shembull i një pjese të planit të veprimit

Qëllimi strategjik 1. Avancim i procesit mësimor përmes zbatimit të metodave bashkëkohore mësimore						
Zhvillimi i qëllimit 1.1 nga mësimi klasor kanë kompetenca të përmirësuara për zbatimin e metodave të nxënies përmes hulumtimit						
Aktivitete	Indikatorë për sukses	Realizues	Korniza kohore për implementim	Resurse të nevojshme	Ekipi për ndjekjen e realizimit të aktiviteteve	Instrumente/burime të informacioneve për ndjekjen e indikatorëve
<p>1. Kërkesë e ofertës për trajnim për nxënie përmes hulumtimit nga provajderët e akredituar dhe përzgjedhjen e ofertës më adekuate</p> <p>2. Realizimi i trajnimit për mësimdhënësit klasorë</p> <p>3. Ndjekje e orëve didaktike nga shërbimi profesional, vlerësim i kompetencave dhe dhënie e informacionit kthyes</p> <p>4. Ndarje të përvojave në aktiv profesional të mësimdhënësve klasorë për avancimin e praktikave mësimdhënëse</p>	<p>Janë trajnuar 15 mësimdhënës dhe përfaqësues të shërbimit profesional</p> <p>Janë ndjekur dhe vlerësuar 30 orë mësimore (para trajnimit dhe pas trajnimit)</p> <p>Kompetenca të përmirësuara janë vlerësuar te 90% e mësimdhënësve</p> <p>Janë mbajtur 10 takime të aktivitetit profesional</p>	<p>Drejtori, Shërbimi profesional</p> <p>Mësimdhënës nga mësimi klasor</p>	<p>Aktivitetet 1 dhe 2 – viti i parë</p> <p>Aktiviteti 3 – viti i parë dhe i dytë</p> <p>Aktiviteti 4 – në vazhdimësi, nga viti i parë deri në vitin e katër</p>	<p>Resurse financiare për trajnim</p> <p>Mjete didaktike për realizimin e mësimin</p>	<p>Drejtor, Shërbimi profesional</p>	<p>Lista e pjesëmarrësve në trajnimin</p> <p>Formati për ndjekjen e orës</p> <p>Procesverbalet nga takimet e aktivitetit profesional</p>

## 6. Struktura e programit zhvillimor të shkollës

1. Të dhëna për shkollën fillore
  - 1.1 Të dhëna identifikimi për shkollën
  - 1.2 Historia e shkollës fillore
2. Pasqyrë e rezultateve të arritura nga Programi paraprak zhvillimor i shkollës.
3. Faktorët që ndikojnë në zhvillimin e shkollës fillore (SWOT analizë)
4. Misioni dhe vizioni i shkollës fillore
5. Prioritete të përzgjedhura dhe arsyetimi për secilin prej tyre
6. Qëllime të definuara strategjike dhe zhvillimore
7. Plane veprimit për realizimin e Programit zhvillimor të shkollës
8. Komisioni për hartim

## Shtojca 1. Skema e roleve të faktorëve



## Shtojca 2. Forma e programit zhvillimor për punën e shkollës fillore

Ballina

Logo dhe stema e SHFK

### **PROGRAMI ZHVILLIMOR PËR PUNËN E SHKOLLËS FILLORE**

---

(shkruhet emri i shkollës fillore, vendit dhe komunës)

**Për periudhën nga \_\_\_\_\_ deri më \_\_\_\_\_ të vitit \_\_\_\_\_**

(periudha me të cilën ka të bëjë Programi zhvillimor)

Vendi për fotografi të shkollës

Data

## **Preambula**

(Përmban nene të Ligjit për arsimin fillor dhe nga Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e programit zhvillimor dhe vjetor për punën e shkollës fillore për hartimin e Programit zhvillimor për punën e shkollës fillore).

<b>Programi zhvillimor i shkollës</b>	
<b>Shkollë</b>	
Adresa	
Telefoni, e-mail	
Periudhë e përgatitjes së Programit zhvillimor të shkollës	
Numri i nxënësve në shkollë	
Numri i shkollave rajonale	
<b>Drejtori i shkollës</b>	
Emri dhe mbiemri	
Nënshkrimi	
Data	
<b>Aprovim nga SHF</b>	
Emri dhe mbiemri	
Nënshkrimi	
Data	



## **Përmbajtja**

- 1. Të dhëna për shkollën fillore**
  - 1.1. Identifikimi i të dhënave për shkollën
  - 1.2. Historia e shkollës fillore
- 2. Pasqyra e rezultateve të arritura nga Programi paraprak zhvillimor i shkollës**
- 3. Faktorët që ndikojnë në zhvillimin e shkollës fillore (SVOT analizë)**
- 4. Misioni dhe vizioni i shkollës fillore**
- 5. Prioritete të përzgjedhura dhe arsyetim për secilin prej tyre**
- 6. Qëllime të definuara strategjike dhe zhvillimore**
- 7. Plane të veprimit për realizimin e Programit zhvillimor të shkollës**
- 8. Komisioni për hartimin e Programit zhvillimor të shkollës**

## 1. Të dhëna për shkollën fillore

### 1.1. Identifikimi i të dhënave për shkollën fillore

Të dhëna	
Emri i shkollës fillore	
Adresa	
Telefoni	
Vendi, komuna	
Ueb – faqja	
E-mail	
Dita e shkollës	
Sipërfaqja e brendshme e shkollës (m2)	
Oborri i shkollës (m2)	
Shkolla rajonale në përbërje të shkollës fillore, vendi	
Kapaciteti i shkollës (numri maksimal i nxënësve)	
Numri i nxënësve (gjendja momentale)	
Numri i paraleleve	
Gjuha/gjuhët në të cilën/cilat realizohet mësimi në shkollë	
Në shkollën fillore ka paralele për nxënës me nevoja të veçanta arsimore	
Numri i ndërrimeve në të cilat realizohet mësimi në shkollë	
Në shkollën fillore ka paralele nga shkolla e muzikës	
Në shkollën fillore ka qendër të resurseve	
Të dhëna të tjera identifikuese karakteristike për shkollën fillore	

### 1.2. Historia e shkollës fillore

(Në këtë pjesë paraqitet zhvillimi kronologjik i shkollës nga formimi deri në miratimin e këtij Programi zhvillimor për punën e shkollës fillore, verifikim i shkollës – kur dhe nga kush, suksese të veçanta të shkollës dhe ajo që është e dallueshme, etj. Teksti përmban 300 fjalë)

## 1. Pasqyrë e rezultateve të arritura nga Programi paraprak zhvillimor i shkollës

(Për secilin qëllim zhvillimor në kuadër të qëllimit strategjik shënohet niveli i realizimit dhe arsyetimit i realizueshmërisë/jorealizueshmërisë së qëllimit – arsyet dhe ndikimi mbi faktorët)

Qëllimi strategjik 1	Qëllime zhvillimore	I realizuar tërësisht	I realizuar pjesërisht	I porealizuar	Arsyetim
	1.1				
	1.2				
	1.3				
Qëllimi strategjik 2	Qëllime zhvillimore	I realizuar tërësisht	I realizuar pjesërisht	I porealizuar	Arsyetim
	2.1				
	2.2				

## 2. Faktorë që ndikojnë në zhvillimin e shkollës fillore (SWOT analizë)

(SWOT analiza bazohet në analizën e rezultateve nga vetevaluimi dhe evaluimi integral, respektivisht nga raportet pas zbatimit të këtyre dy proceseve, ndërsa ka të bëjë me funksionimin e shkollës, anët e forta të saj, anët e dobëta dhe resurset shikuar nga kënde të ndryshme (të punësuar, nxënës, përfaqësues të bashkësisë lokale) në të gjitha fushat e punës së shkollës.)

### SWOT analizë

Përparësitë (anët e forta) të shkollës fillore	Dobësitë (anët e dobëta) të shkollës fillore
<b>Mundësi (raste) që rezultojnë nga shkolla dhe mjedisi i saj</b>	<b>Kërcënime, pengesa (rreziqe) që rezultojnë nga shkolla dhe mjedisi i saj</b>

--	--

### 3. Misioni dhe vizioni i shkollës fillore

**Misioni** i shkollës ka të bëjë me qëllimin e ekzistimit të shkollës dhe në të janë përfshirë vlerat themelore, besimet, pritjet dhe interesat e subjekteve kyçe në procesin edukativo-arsimor. Përmes deklaratë për misionin, në fakt, fitohet pasqyrë për atë se cila shkollë, çfarë ofron dhe çfarë bën.

**Vizioni** i shkollës paraqet projeksion të së ardhmes, pasqyrë të dëshiruar të shkollës drejt të cilit synon.

### 4. Prioritete të zgjedhura dhe arsyetim i secilit prej tyre

(Përmenden prioritetet e përzgjedhura dhe arsyetimi për rëndësinë e atij prioriteti)

Prioriteti	Arsyetimi

### 5. Qëllime të definuara strategjike dhe zhvillimore

**Nga prioritetet ndaj qëllimeve strategjike** (përmendet prioriteti ose grupi i prioritetëve për të cilat definohet qëllimi strategjik)

Prioritet-i /et	Qëllimi strategjik

**Nga qëllimet strategjike drejt qëllimeve zhvillimore** (për çdo qëllim strategjik definohen 2-3 qëllime zhvillimore)

Qëllimi strategjik 1	Qëllime zhvillimore
	1.1
	1.2

	1.3
Qëllimi strategjik 2	Qëllime zhvillimore
	2.1
	2.2
Qëllimi strategjik 3	Qëllime zhvillimore
	3.1
	3.2
	3.3

## 6. Planet e veprimit për realizimin e programit zhvillimor të shkollës

<b>Qëllimi strategjik 1.</b> (Përmendet qëllimi strategjik)						
<b>Qëllimi zhvillimor 1.1</b> (Përmendet qëllimi zhvillimor)						
Aktivitetet	Indikatorët për sukses	Realizuesit	Korniza kohore për implementim	Resurse të nevojshme	Ekipi për ndjekjen e realizimit të aktiviteteve	Instrumente /burime të informacioneve për ndjekjen e indikatorëve
<b>Qëllimi zhvillimor 1.2</b> (Bëhet e ditur në qëllimin zhvillimor)						
Aktivitetet	Indikatorët për sukses	Bartësit e aktiviteve	Korniza kohore për implementim	Resurse të nevojshme	Ekipi për ndjekjen e realizimit të aktiviteve	Instrumente /burime të informacioneve për ndjekjen e indikatorëve

(Për çdo qëllim strategjik krijohet tabelë në të cilën përmenden: qëllimi strategjik, qëllimet zhvillimore, aktivitetet për çdo qëllim zhvillimor, indikatorët për sukses për secilin aktivitet, bartësit e aktivitetit, korniza kohore për implementimin e tij , resurset e nevojshme, ekipi për ndjekjen e realizimit të aktivitetit dhe instrumenteve/burimeve të informacioneve për ndjekje).

**7. Komisioni për hartimin e Programit zhvillimor për punën e shkollës fillore**

(Përmenden emrat dhe pozicionet e punës të atyre që e kanë hartuar Programin zhvillimor për punë të shkollës fillore)

Në faqen e fundit ka vend për vulë, për datë dhe nënshkrimin e drejtorit të shkollës fillore dhe për nënshkrimin e kryetarit të Këshillit shkollor.

### Shtojca 3. Lista për kontrollin e pjesëmarrjes së faktorëve në procesin e hartimit të Programit zhvillimor të shkollës

(vërehet pjesëmarrje me shenjë dhe shkruhet emri i personit që ka qenë i përfshirë drejtpërdrejt)

	Drejtorja e shkollës	Këshilli shkollor	Kuadri edukativo arsimor	Nxënës	Prindër	Bashkësia lokale
SVOT analizë						
Misioni, vizioni						
Shqyrtim i prioriteteve dhe përzgjedhja						
Definimi i qëllimeve						
Hartimi i planeve të veprimit						
Hartimi i dokumentit final të Programit zhvillimor						

## Shtojca 4. Lloji i indikatorëve

**Indikatorët për sukses** paraqesin udhërrëfyes të cilët përmes matjes së veprimeve ose ndryshimeve konkrete, kuantitative bëjnë të ditur nëse me aktivitetin i afrohem qëllimit të dëshiruar.

Sipas llojit, indikatorët mund të ndahen në tre lloje:

1. **Indikatorët hyrës**, të cilët masin resurset e investuar në aktivitetin, siç janë shpërndarja e buxhetit, kuadri dhe materialet e siguruara.
2. **Indikatorët e procesit**, që vlerësojnë implementimin e aktiviteteve, siç është numri i trajnimeve të zbatuara ose përqindjen e nxënësve të cilët marrin pjesë në programe konkrete.
3. **Indikatorët dalës**, të cilët nënkuptojnë matjen e rezultateve të arritura me aktivitetet, siç është numri i mësimdhënësve të trajnuar, përqindja e mësimdhënësve të trajnuar të cilët e zbatojnë atë që e kanë mësuar në trajnimin, numrin e nxënësve që e kanë përmirësuar suksesin e shkollës si rezultat i aktiviteteve.

Sipas nivelit të analizës, indikatorët mund të jenë:

- **Indikatorë të cilët janë të lidhur me personalitet** – i masin karakteristikat individuale, sjelljet dhe arritjet e përdoruesve të aktiviteteve, siç janë arritjet e përmirësuara të nxënësve ose përqindje e rritur e nxënësve që janë të pranishëm në aktivitete.
- **Indikatorë të cilët nuk janë të lidhur me personalitet** - i masin karakteristikat e mjedisit ose sistemit në të cilin funksionon shkolla, siç janë infrastruktura shkollore ose ndryshimet në nivel sistemor ose institucional, siç janë ndryshimet në politikat dhe praktikat shkollore.